



Periodiku AMF

I. Raporti i Mbikëqyrjes 2007, publikim i ri i AMF

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i ka shtuar listës së publikimeve një publikim të ri, Raportin e Mbikëqyrjes të Tregut të Sigurimeve për vitin 2007.

Vijon në faqen 2

II. Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

II. 1 Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar - gusht 2008

Në periudhën janar – gusht 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 4,568,575 mijë lekë, përkundrajt 4,027,310 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007.

Vijon në faqen 3

III. Ngjarje dhe zhvillime të tjera

III. 1 Pjesëmarrje në takimin rajonal të grupit të punës 4, “Shërbimet Financiare”

Në kuadër të komponentit për mbrojtjen e konsumatorit me financim të GTZ-ORF (Fondi i Hapur Rajonal për Reformën Ligjore në Vendet e Evropës Juglindore) u zhvillua në datat 1-4 shtator 2008, në Ohër, Maqedoni, takimi rajonal i grupit të punës 4, “Shërbimet financiare”.

Vijon në faqen 4

III. 2 Pjesëmarrje në shkollën verore aktuariale të Varshavës

Ministria e Financave, Poloni, në bashkëpunim me Shoqërinë Polake të Aktuarëve; Departamentin e Ekonomisë në Universitetin e Varshavës, Poloni; Universitetin e Western Ontario, Kanada; City University, Britani e Madhe; Universitetin Pierre et Marie Curie, Francë, etj, organizuan gjatë periudhës 11 – 19 shtator 2008, shkollën verore aktuariale, e cila zhvillohet çdo vit që nga viti 1990 në Varshavë, Poloni.

Vijon në faqen 5

III. 3 Zhvillohet Konferenca për integrimin e mikrosigurimeve – Çështje të rregullimit, mbikëqyrjes dhe politikave

Instituti Financiar për Stabilitet, në bashkëpunim me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare, organizuan në Bazel, Zvicër, nga data 16 – 18

shtator 2008, konferencën për integrimin e mikrosigurimeve në sistemin financiar si dhe çështje që lidhen me rregullimin, mbikëqyrjen dhe politikat.

Vijon në faqen 6

III. 4 Pjesëmarrje në konferencën rajonale mbi tregun e sigurimeve në Evropën Juglindore dhe Evropën Qendrore, si dhe legjislacionet e tyre

Agjencia e Sigurimeve të Bosnje Hercegovinës në bashkëpunim me Komisionin e Mbikëqyrjes Financiare të Republikës Bullgare, zhvilloi në Sarajevë, Bosnje Hercegovinë, më datë 29 shtator 2008, konferencën rajonale mbi Tregun e Sigurimeve në Evropën Juglindore dhe Evropën Qendrore si dhe rregulloret e tyre.

Vijon në faqen 8

III. 5 Zhvillohet seminari rajonal për auditin e brendshëm të bankave qendrore dhe autoriteteve rregullatore të sistemit financiar.

Gjatë periudhës 22 - 26 shtator 2008, në ambientet e Bankës Federale të Rezervave të Filadelfias, USA, u zhvillua seminari rajonal, mbi auditin e brendshëm në bankat qendrore dhe autoritetet rregullatore të sektorit financiar.

Vijon në faqen 9

III. 6 Zhvillohet seminari mbi ecurinë e strukturës dhe metodat e vlerësimit në mbikëqyrjen e aftësisë paguese me bazë riskun, në industrinë e sigurimeve

FSI (Financial Stability Institute) në bashkëpunim me BIS (Bank for International Settlements) organizuan gjatë periudhës 30 shtator - 2 tetor 2008, në Basel, seminarin rajonal me temë: “Ecuria e strukturës dhe metodat e vlerësimit në mbikëqyrjen e aftësisë paguese me bazë riskun, në industrinë e sigurimeve.

Vijon në faqen 10

IV. Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private

Kapitulli 4(Pjesë e shkëputur nga botimi i OECD: “Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private”) Programe dhe instrumenta për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj riskut dhe edukimit mbi çështjet e sigurimeve

Vijon në faqen 11

Në këtë numër:

Raporti i Mbikëqyrjes 2007, publikim i ri i AMF

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

4

Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private

11

Raporti i Mbikëqyrjes 2007, publikim i ri i AMF

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i ka shtuar listës së publikimeve një publikim të ri, Raportin e Mbikëqyrjes të Tregut të Sigurimeve për vitin 2007.

Mbikëqyrja e tregut financiar jo bankar, dhe në veçanti e tregut të sigurimeve, ushtrohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bazë të ligjit nr. 9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" si dhe ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare".

Misioni themelor i AMF-së, në zbatim të përgjegjësisve ligjore si autoritet mbikëqyrës, është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, e lidhur ngushtë me sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur, duke garantuar përmbushjen e dispozitave ligjore.

Viti 2007 ka qenë një vit i rëndësishëm për nga zhvillimet që zunë vend në tregun e sigurimeve. Rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor që rregullon sektorët e mbikëqyrur ka qenë prioritet i punës së AMF-së gjatë vitit 2007. Brenda një periudhe dymbëdhjetë mujore, shoqëritë e sigurimit duhet të dispononin kapital minimal në formën e fondit të garancisë në nivelet e vendeve të BE-së. Kështu Fondi i Garancisë si për shoqëritë e sigurimit të jetës dhe ato të jo jetës duhet të jetë minimalisht në masën 370 mln lekë. I gjithë procesi i rritjes së kapitalit në të gjitha format e përzgjedhura nga shoqëritë e sigurimit është ndjekur me përparësi nga AMF, ku dhe është mbyllur me sukses.

Kërkesat gjithnjë e në rritje të tregut për informacion të specializuar me karakter financiar, dinamika e zhvillimit të tij, si dhe

forcimi i transparencës nga ana e AMF në komunikimin me publikun, kanë qenë ndër faktorët kryesorë në hartimin e këtij publikimi, në thelb të së cilit, është informacioni statistikor - financiar i detajuar dhe tepër i strukturuar. Një strukturim i tillë do të plotësojë vakumin e deritanishëm për informacion me karakter tekniko - financiar. Kështu, përveç testeve IRIS për tregun, të dhënave makro dhe informacionit tekniko-financiar për tregun e jetës dhe të jo jetës, një vend të rëndësishëm zënë dhe treguesit tekniko-financiarë të disa prej portofoleve me peshë më të rëndësishme, me qëllim analizimin e tendencave në vite. Përdoruesit e këtij publikimi mendohet të jenë të shumtë, duke filluar që nga vetë operatorët e tregut, investitorët e huaj, analistët e ndryshëm dhe deri për qëllime akademike.

Raporti i Mbikëqyrjes është produkt i bashkëpunimit të dy drejtorive, përkatësisht Drejtorisë së Kërkimit dhe Statistikës si dhe Drejtorisë së Raportimit dhe Analizës.

Në vijim, AMF do të realizojë misionin e vet mbikëqyrës nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës, në përputhje me parimet ndërkombëtare, bashkërendimit të analizës së dokumentacionit financiar dhe mbikëqyrjes në vend të tregut, orientimit në procesin e mbikëqyrjes drejt mbikëqyrjes me bazë risku, ndërmarrjes së politikave zhvilluese për tregun, trajnimit të burimeve njerëzore drejt një mbikëqyrje të cilësisë së lartë.

Shpresojmë që ky publikim t'i përgjigjet nevojave të publikut të gjerë për informacion dhe të shërbejë si pikë nisje për forcimin e mëtejshëm të transparencës në kuadrin e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura


I. Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar - gusht 2008

Në periudhën janar – gusht 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 4,568,575 mijë lekë, përkundrejt 4,027,310 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Kështu, tregu i sigurimeve shënoi një rritje në masën 13.44 % nga viti i kaluar, ku 84.70 % e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo Jetës, ndërsa 15.30 % tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, u shënuar një rritje në masën 32.73 % të sigurimeve të Jetës dhe 12.15 % të sigurimeve të Jo Jetës.


Në periudhën janar – gusht 2008, volumi i primeve të sigurimit të detyrueshëm u rrit në masën 0.04 %, ndërsa volumi i primeve të sigurimit vullnetar të Jo Jetës u rrit në masën 41.55 %.

Në periudhën janar – gusht 2008 u lidhën 448,665 kontrata sigurimi përkundrejt 365,687 kontrata të lidhura në të njëjtën periudhë të

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto për periudhën janar – gusht 2008 (Jeta dhe Jo Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit për periudhën janar – gusht 2008 (Jo Jeta)



Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar - gusht

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2007	2008
Periudha janar - gusht		
A) Sigurim i Jetës	252,969	335,776
B) Sigurim i Jo Jetës	3,774,341	4,232,798
<i>nga këto</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	2,673,281	2,674,297
b) Sigurimi Vullnetar	1,101,060	1,558,501
TOTAL	4,027,310	4,568,575

vitit 2007. Numri i kontratave të sigurimit të Jo Jetës kapi vlerën 413,090 nga 342,029 që i takojnë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Portofoli MTPL ka shënuar rritjen më të madhe të numrit të kontratave me 11,259 kontrata ose në masën 7.86 % më shumë se janar – gusht 2007.

Vlen të përmendet rritja në masën 50.37 % e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kapi vlerën 35,575 nga të cilat sigurimi “Jeta dhe Shëndeti në udhëtim” pati një rritje prej 4,789 kontrata ose 56.98 %, duke shënuar dhe dinamikën më të lartë në rritjen e kontratave të sigurimit të Jetës.

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - gusht 2008 ishte rreth 907,176 mijë lekë, ose 2.53 % më pak se në janar - gusht të vitit 2007. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto u përket sigurimeve motorrike me 739,062 mijë lekë, apo 83.66 % të totalit. Kjo ulje në dëmet e paguara bruto ndihet në portofolin "Kartoni Jeshil" ku kemi një ulje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me rreth 22.37 % dhe ulje të numrit të dëmeve të paguara me rreth 29.62 % krahasuar me 8 mujin e parë të vitit 2007.

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

I. Pjesëmarrje në takimin rajonal të grupit të punës 4, “Shërbimet Financiare”

Në kuadër të komponentit për mbrojtjen e konsumatorit me financim të GTZ-ORF (Fondi i Hapur Rajonal për Reformën Ligjore në Vendet e Evropës Juglindore) u zhvillua në datat 1-4 shtator 2008, në Ohër, Maqedoni, takimi rajonal

i grupit të punës 4, “Shërbimet financiare”.



Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga institucionet shtetërore dhe shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit nga: Shqipëria, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia, Bosnje-Hercegovina, Kroacia.

Synimi i këtij takimi ishte vlerësimi i sektorit të shërbimeve financiare në tre drejtimit e tij kryesore: shërbimi bankar, sigurimet dhe titujt. Pas prezantimeve të përfaqësuesve të institucioneve financiare shtetërore u bënë prezantimet nga shoqatat e konsumatorëve.

Temat kryesore të diskutimeve ishin:

- o Kuadri ligjor i shërbimeve financiare në vendet e rajonit.*
- o Informimi dhe pjesëmarrja e konsumatorit.*
- o Komunikimi bashkëveprues me konsumatorët për cilësinë dhe mbrojtjen që ofrojnë shërbimet financiare.*
- o Roli i mediave dhe ndërgjegjësimi i publikut.*
- o Zbatimi i politikave evropiane për të siguruar infrastrukturë efiçente të tregjeve financiare.*

Në përfundim të takimit të gjithë pjesëmarrësit arritën në përfundimin, se :

- o Institucionet financiare shtetërore duhet të përfshijnë më shumë organizatat jofitimprurëse në të gjitha çështjet që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit, duke filluar që*

nga momenti i hartimit dhe zbatimit të legjislacionit përkatës.

o Kuadri ligjor në vendet e rajonit duhet përmirësuar në funksion të mbrojtjes së konsumatorit.

o Përveç Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë dhe Bankës Kombëtare të Serbisë, asnjë nga vendet pjesëmarrëse nuk kishte ngritur njësi të specializuar për mbrojtjen e konsumatorit.

o Ndërgjegjësimi i publikut në rajon është rritur si rezultat i fushatave mediatike dhe disa publikimeve. Megjithatë u rekomandua shpërndarje më e mirë e informacionit për konsumatorët lidhur shërbimet financiare.

o Nevoja për trajnime, si për forcimin e kapaciteteve në institucionet shtetërore, ashtu dhe në grupet e konsumatorëve, mbetet prioritet për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të konsumatorëve si dhe ofrimin e shërbimeve financiare të sigurta.

II. Pjesëmarrje në shkollën verore aktuariale të Varshavës

Ministria e Financave, Poloni, në bashkëpunim me Shoqërinë Polake të Aktuarëve; Departamentin e Ekonomisë në Universitetin e Varshavës, Poloni; Universitetin e Western Ontario, Kanada; City University, Britani e Madhe; Universitetin Pierre et Marie Curie, Francë, etj, organizuan gjatë periudhës 11 – 19 shtator 2008, shkollën verore aktuariale, e cila zhvillohet çdo vit që nga viti 1990 në Varshavë, Poloni. prioritet për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të konsumatorëve si dhe ofrimin e shërbimeve financiare të sigurta.

Qëllimi i shkollës është të aftësojë studentët që të përdorin metodat bashkëkohore të shkencave aktuariale në industrinë e sigurimit të Jetës dhe

të Jo Jetës sipas standardeve profesionale perëndimore, si dhe sipas zhvillimit jo të qëndrueshëm të ekonomive në tranzicion, duke u përshtatur me ekonominë e Evropës Lindore dhe Qendrore.



Kjo shkollë ka ndihmuar në përgatitjen për studimet pasuniversitare, si dhe në ngritjen e nivelit të profesionit të një numri të konsiderueshëm studentësh në nivel ndërkombëtar.

Në fillimet e saj, shkolla është drejtuar nga Dr. Krystztof Stroinski, profesor pranë Universitetit të Western Ontario, Kanada dhe pas vitit 1996, kjo shkollë u drejtua nga Prof. Wojciech Otto duke u ndihmuar më vonë në vitin 2001 nga Dr. Krystztof Stroinski, dhe Z. Michal Gorski president i Shoqatës Aktuariale Polake.



Misioni i Shkollës Verore, pas diskutimesh midis Universitetit dhe Shoqatës Aktuariale të Varshavës, prej vitit 2002, ndryshoi në edukimin në avancim të vazhdueshëm, duke lënë çështjen e edukimit bazë në programe e kurse më të rregullta akademike. Në përgatitjen e programit të ri u ndërtua një komitet në të cilin u angazhuan Dr. Piotr Szlenk, Kryetar i Komitetit të Shoqatës Aktuariale Polake e përgjegjës për edukimin në emër të bordit të kësaj shoqate, Prof. Wojciech Otto, Drejtor i Shkollës, pedagog pranë Universitetit të Varshavës, si dhe Z. Piotr Borowski, anëtar i bordit të Shoqatës Aktuariale Polake.

Në vitin 2003, qëllimi i shkollës ka qenë mbushja e një boshllëku në procesin e edukimit në vazhdueshmëri, gjë e cila njihet si çështje thelbësore në mbajtjen lart të standardeve profesionale në pjesën më të madhe të vendeve perëndimore, të cilat kanë tregje sigurimesh mëse të zhvilluara, si dhe një traditë të gjatë aktuariale. Bazuar në këto linja, Komiteti ka ndërtuar programin e temave të avancuara për edicionin e 14 të WASS në vitin 2003.

Programi i edicionit të 19 përbëhej prej tre temave, që si gjatë edicioneve të pesë viteve të mëparshme ishte punuar për mos përsëritjen e programeve paraardhëse.

Në kursin që u mbajt nga data 11 – 12 Shtator, u trajtua tema e parë: *Metodat statistikore në përlllogaritjen e provigjoneve teknike të dëmeve*, nga Dr. Thomas Mack, ish Shef i Aktuaristikës të Munich Re, Munich.

Në kursin që u mbajt nga data 15 – 17 Shtator, u trajtua tema e dytë: *Roli i ERM (Menaxhimi i rrezikut të ndërmarrjeve)* nga Z. Tom Veerman Msc AAG RBA, Z. Franek Gregorkiewicz Msc, dhe Z. Johan Voortman Msc FRM, nga Triple A. Në kursin që u mbajt nga data 18 – 19 Shtator, u trajtua tema e tretë: *Anuitetet e ndryshueshme*

nga Zj. Paola Luraschi, Z. Paul Ernest dhe Zj. Beata Golembiecka, nga Milliman.

Programi i përshtatej personave, të cilët tashmë kanë arritur një nivel të caktuar në profesionin e aktuarit, ose të paktën kanë kompletuar edukimin bazë të WASS apo të një vendi tjetër.

Shkolla verore aktuariale e Varshavës, gjeti interes dhe u vlerësua nga pjesëmarrësit.

III. Zhvillohet Konferenca për integrimin e mikrosigurimeve – Çështje të rregullimit, mbikëqyrjes dhe politikave

Instituti Financiar për Stabilitet, në bashkëpunim me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare, organizuan në Bazel, Zvicër, nga data 16 – 18 shtator 2008, konferencën për integrimin e mikrosigurimeve në sistemin financiar si dhe çështje që lidhen me rregullimin, mbikëqyrjen dhe politikat.

Në konferencë u prezantua roli rregullues në zhvillimin e tregut të mikrosigurimeve. Thelbi i mikrosigurimeve është “Zhvillimi i tregut të sigurimeve në funksion të të varfërve”. Mundësia e sigurimeve është një strategji e rëndësishme për reduktimin e varfërisë.

Objektivat e konferencës, ishin paraqitja në mënyrë të thjeshtë e zhvillimit të mikrosigurimeve në pesë vende (Kolumbi, Indi dhe Filipinet, Afrika e Jugut dhe Uganda) ku produktet, rregullat dhe mbikëqyrja në zhvillimin e tregut të mikrosigurimeve kanë ecur konsiderueshëm.

Tabela përmbledhëse e pesë shteteve

		Kolumbia	India	Filipine	Afrika Jugut	Uganda
Popullsia(m)		46m	1.1b.n	89m	47m	28m
Urbanizimi		57%	29%	63%	59%	13%
Popullsia<\$1(PPP axhustuar)		93%	61%	93%	82%	82%
Popullsia<\$2(PPP axhustuar)		8%	40% rurale,20% urbane	14%	23%	96%
Primet ndaj GDP	Biznesi Jetës	0.7%	4.1%	0.9%	13.0%	e pa përfillshme
	Biznesi Jo-Jetës (aksident+shëndet)	1.7%	0.6%	0.5%	3.0%	0.6%
Ndarja e tregut formal M.Sigurimeve (% e primeve)		5%	1%	3%	<2%	e paditur
Policmbajtësit në M.Sigurime % e axhustuar(formal)		9% (2.7m) 19%(5.7m)përfshirë Informalin	1.95% (13.7m) 2% (14m) përfshirë Informalin	3.1% (1.7m) 5.4%(2.9m)përfshirë Informalin	16% (4.9m) 30%(9m)përfshirë Informalin	5%(0.6m) I papërfillshëm Informali
Vlerësimi i tregut M.Sigurimeve sipas përbërjes	Tregu formal nga i cili:	48%	98%	59%	54%	pothuajse 100%
	Formal i përbashkët / pjesmarja e bashkëvepruesve në tregun formal	62% (1.7m)	Kufizimi (grupimi më poshtë)	32%	<10%	aktualisht
	Kreditimi i detyrueshëm-sigurimi i shoferit pjesmarja në total formal	27%(rreth 750k)	90%	49%	41%(2m) (22% i total tregu M.Sig)	100%
	Informal /jo i rregullt	52% (3m të 5.7m)	20%	41%	46%	e papërfillshme
Karakteristikat specifike		Liberalizimi financiar dhe kriza 1990	Privatizimi i tanishëm dominon në treg	Pozita shtrënguese dhe M. Sig. Jeta në kredi dhe makina;duke adoptuar pozita rregulluese	Të ardhura të pakta nga produktet dhe zgjerimi i sektorit formal	Tregu shumë i vogël, rregullat së fundmi po stabilizohen
Rregullat	Përmendim(min kap, kërkesa për taksa,etj)	\$3-4.2m min(varur nga linja e biznesit)	\$25m	-\$24m-biznesi I ri -\$3m-MBAs e re (\$305k MBAs ezistuese) -\$122k-MI, MBS, deri në \$305k,	\$1.3m,jeta \$0.7, jo-jeta	\$580k(përbërje dyfish)
	Ndërmjetësi	Nivel i ulët hyrjeje dhe detyrim rregullues	Ekzistenca e frenimit me përjashtim të ndërmjetësit çelsi i rrjetit me të ardhura të pakta Kërkesa në rritje e shpenzimeve për biznes	Nivel i ulët hyrjeje dhe detyrim rregullues	Mundësi kufizuese me të ardhura të pakta Masatë mundësi rregulluese, për shitje Pajtimi i ulët për informim shitje	Kërkesa për shpërblim e ndërmjetësit

Nga faktet e dhëna, lëvizja në këto vende në drejtim të takimit me policëmbajtësit, rregullat dhe mbikëqyrja, shihen si suport i zhvillimit të mikrosigurimeve sipas juridiksioneve. Vlen të theksohet se nuk ka ndonjë recetë në zhvillimin e mikrosigurimeve, po ai duhet të trajtohet si informim gjithëpërfshirës në përputhje me kushtet e brendshme dhe i axhustuar vazhdimisht me ndryshimet e mjedisit.

Mikrosigurimet janë përcaktuar nga IAIS (2007 b) si “sigurimet që aksesohen nga popullsia me të ardhura të ulëta, ofruar nga një sërë entesh të ndryshme, por të administruara në përputhje me praktikën e përgjithshme të pranuar të sigurimeve (të cilat duhet të përfshijnë Parimet Bazë të Sigurimeve). Çka është më e rëndësishme, kjo do të thotë që risqet e siguruar nëpërmjet policës së mikrosigurimit menaxhohen bazuar në parimet e sigurimeve dhe financohen nga primet”. Si

pasojë përjashtohet asistenca sociale si dhe ndihma urgjente të ofruara nga qeveritë, pasi këto nuk janë të financuara nga primet e lidhura me riskun, dhe përfitimet nuk paguhen nga grumbullimi i fondeve të cilat menaxhohen sipas parimeve të sigurimeve dhe të riskut”.

Aksesi në sigurime është një strategji e rëndësishme në reduktimin e varfërisë. Pamundësia për të menaxhuar dëmet e shkaktuara nga vdekja e papritur e një anëtar të familjes, sëmundjeve, humbja e të ardhurave ose e pronës, janë faktorë që thellojnë më tej varfërinë. Tregjet financiare – dhe në veçanti shërbimet e sigurimeve – mund të luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e humbjeve pasurore që rezultojnë nga këto risqe. Megjithatë, këto shërbime janë të paarritshme për miliona të varfër dhe shtresat në nevojë. Pavarësisht nga rritja e rëndësisë dhe shtrirja e shpejtë e mikrosigurimeve shumë skema të mikrosigurimeve janë tepër të vogla në mbulimin që ofrojnë, duke lënë pjesën më të madhe të njerëzve të varfër pa mbrojtjen e duhur.

Struktura analitike e mikrosigurimeve

- *Struktura e përfshirjes financiare.*
- *Kufijtë e mundshëm.*
- *Qëllimi i mikrosigurimeve.*
- *Përkufizime të mikrosigurimeve.*
- *Lidhja e vlerave në sigurime.*
- *Ndryshimi ndërmjet formales dhe informales.*
- *Kategoritë e riskut.*
- *Polica, rregullat dhe mbikëqyrja.*
- *Trajtimi metodologjik.*

IV. Pjesëmarrje në konferencën rajonale mbi tregun e sigurimeve në Evropën Juglindore dhe Evropën Qendrore, si dhe legjislacionet e tyre

Agjencia e Sigurimeve të Bosnje Hercegovinës në bashkëpunim me Komisionin e Mbikëqyrjes Financiare të Republikës Bullgare, zhvilloi në Sarajevë, Bosnje Hercegovinë, më datë 29 shtator 2008, konferencën rajonale mbi Tregun e Sigurimeve në Evropën Juglindore dhe Evropën Qendrore si dhe rregulloret e tyre.



Regional Conference Sarajevo, September 29th, 2008

Konferenca ishte finalizimi i projektit binjak midis Agjencisë së Sigurimeve të Bosnje Hercegovinës me Komisionin e Mbikëqyrjes Financiare të Republikës Bullgare. Pjesëmarrësit në këtë konferencë ishin nga vende të ndryshme të botës, nëpunës të bankave qendrore, ministrive të financave si dhe agjencive rregullatore. Ajo u organizua në formën e prezantimeve dhënë nga lektorë të vendeve të ndryshme, si Sllovakia, Bullgaria Polonia e Maqedonia. Ndër temat më të rëndësishme që u trajtuan në

këtë konferencë ishin: (i) *Globalizimi i riskut* .(ii) *Legjislacioni dhe zhvillimet e tregut të sigurimeve në vendet e rajonit* (iii) *Legjislacioni dhe praktikat për mbrojtjen e konsumatorit, si dhe shkëmbimi i informacionit midis vendeve mbikëqyrëse*. (iv) *Sigurimi MTPL dhe mekanizmat për parandalimin e mos sigurimit* . (v) *Efekti i Solvency II në legjislacionin e ardhshëm në EU. Në fund të konferencës, ekspertët sollën eksperiencën e vendeve të tyre, duke sjellë praktika të ndryshme.*

Një argument i rëndësishëm që u trajtua ishte edhe *efekti i Solvency II në legjislacionin EU dhe në disiplinën e tregut.*

Në konferencë u dhanë disa rekomandime për vendet e rajonit si :

o Monitorimi i aftësisë paguese duhet të bëhet sipas tipareve të tregut.

o Të identifikohen të gjithë faktorët që kontribuojnë në aftësinë paguese.

o Të mënjanohej rregullat që shtrembërojnë tregun.

o Të promovohet disiplina e tregut.

Në fund të Konferencës, pjesëmarrësit diskutuan dhe shkëmbyen pyetje rreth çështjeve të ndryshme të procesit mbikëqyrës dhe sfidat praktike që i shfaqeshin çdo Autoriteti Mbikëqyrës të përfaqësuar

V. Zhvillohet seminari rajonal për auditin e brendshëm të bankave qendrore dhe autoriteteve rregullatore të sistemit financiar.

Gjatë periudhës 22 - 26 shtator 2008, në ambientet e Bankës Federale të Rezervave të Filadelfias, USA, u zhvillua seminari rajonal, mbi auditin e brendshëm në bankat qendrore dhe autoritetet rregullatore të sektorit financiar,

i organizuar nga Banka Federale e Rezervave të Filadelfias dhe Programi Partner për Stabilitetin Financiar, PFS Program.



Në këtë seminar morën pjesë, përveç përfaqësuesit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës dhe përfaqësues nga bankat qendrore të vendeve të ndryshme, si Poloni, Lituani, Kroaci, Armeni, Azerbaxhan, Mali i Zi, Bosnje-Hercegovinë, etj.

Në ditën e parë, pjesëmarrësit i përshëndeti zv/Presidenti Ekzekutiv i Bankës Federale të Rezervave të Filadelfias, z. Rick Lang, i cili bëri një përshkrim të punës së auditit të brendshëm në sistemin e rezervave federale të USA. Më pas, çdo pjesëmarrës bëri një prezantim të shkurtër të institucionit të tij.

Disa nga temat kryesore që u trajtuan nga lektorë të ndryshëm në këtë seminar ishin:

o Menaxhimi i riskut të një sipërmarrje.

o Audit i teknologjisë së informacionit.

o Përmbledhje të auditit të sigurisë së informacionit dhe akteve të menaxhimit të sigurisë së informacionit.

o Ekipet përgjegjëse për incidentet në sistemin kombëtar të rezervave federale.

o Mbrojtja e integritetit të informacionit të Bankës Qendrore të USA.

o Krimet në rrjetin informatik.



- o Lufta kundër mashtrimeve dhe abuzimeve.*
- o Tendencat e formave të pagesave dhe mashtrimet.*
- o Kontrolli kundër mashtrimeve.*
- o Përmbledhje e sistemit Fedwire të pagesave në rezervat federale.*
- o Roli i FBI në zbulimin e rasteve të ndërhyrjes së piratëve të informatikës në rrjetet e sistemit bankar, etj.*

Seminari u zhvillua në mënyrë bashkëbisedimi, ku gjatë trajtimit të të gjitha temave, pjesëmarrësit ndërhyjnë duke dhënë eksperiencat e vendeve të tyre, si dhe duke bërë pyetje të ndryshme për të zhvilluar dhe qartësuar më tepër çështjet e trajtuara. Përveç seancave teorike, të cilat u diskutuan gjatë seminarit, u bënë dhe vizita të ndryshme në ambientet e thesarit të bankës ku kryheshin veprimet me cash-in, në godinën ku priteshin monedhat metalike, në ambientet ku prodhoheshin çeqet bankare, muzeun e parasë në qarkullim, etj. Në fund të këtij seminarit, për të gjithë pjesëmarrësit u ndanë certifikata.

VI. Zhvillohet seminari mbi ecurinë e strukturës dhe metodat e vlerësimit në mbikëqyrjen e aftësisë paguese me bazë riskun, në industrinë e sigurimeve

FSI (Financial Stability Institute) në bashkëpunim me BIS (Bank for International Settlements) organizuan gjatë periudhës 30 shtator - 2 tetor 2008, në Basel, seminarin rajonal me temë: *“Ecuria e strukturës dhe metodat e vlerësimit në mbikëqyrjen e aftësisë paguese me bazë riskun, në industrinë e sigurimeve.”* Gjatë ditëve të seminarit u trajtuan këto tema:



- o Struktura e Solvency II.*
- o IFRS, Faza II – Standardet e reja të kontabilitetit për sigurimet.*
- o Menaxhimi i riskut të tregut në kontratat e sigurimit.*
- o Menaxhimi i riskut të ndërmarrjeve në aspektin e aftësisë paguese.*
- o Metodat për përcaktimin e masës së riskut.*
- o Përdorimi i modeleve të brendshme për riskun dhe qëllimet e menaxhimit të kapitalit.*
- o Llogaritjet për kapitalin duke përdorur mënyrat standarde.*
- o Inspektimi i mbikëqyrjes në menaxhimin e riskut të ndërmarrjes dhe miratimi i modeleve të brendshme.*
- o Roli i stresit dhe ekzaminimi i planit të veprimeve në një regjim të solvency bazuar në risk.*
- o Modelimi i grupit dhe shumëllojshmëria e përfitimeve.*
- o Struktura ndërkombëtare për aftësinë paguese bazuar në risk.*
- o Struktura ndërkombëtare për mbikëqyrjen e aftësinë paguese me bazë risku – hapa të mëtejshme.*

Në seminar morën pjesë lektorë nga autoritete të ndryshme të Evropës, si BAFIN (Autoriteti Mbikëqyrës i Gjermanisë), FSA UK, ACAM (Autoriteti Mbikëqyrës i Francës), OSFI (Zyra e Mbikëqyrjes së Institucioneve Financiare të Kanadasë), si dhe nga kompani prestigjioze të Munich Re, Ernst & Young.

Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private

Kapitulli 4 (Pjesë e shkëputur nga botimi i OECD: “Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private”)

Programe dhe instrumenta për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj riskut dhe edukimit mbi çështjet e sigurimeve

1. Programe që targetojnë risqe të mëdha dhe popullatat e prekura

Informacioni i cili ka si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi risqet dhe mbi rëndësinë e mbrojtjes ndaj risqeve të mëdha, përfshirë nëpërmjet sigurimit, është zakonisht një çështje për qeveritë, për të paktën për risqe katastrofike dhe risqe afatgjatë (p.sh. sigurimi i jetës për pension, kujdesi afatgjatë dhe invaliditeti) që njerëzit në përgjithësi nuk arrijnë t'i kuptojnë dhe administrojnë në një mënyrë të arsyeshme dhe të qëndrueshme. Në Meksikë, Fondi Kombëtar për Fatkeqësitë Natyrore (FONDEN) organizon fushata mbi parandalimin dhe mbrojtjen nga risku i fatkeqësive. Në Izrael, janë inkurajuar disa fushata ndërgjegjësimi mbi masat parandaluese dhe të sigurimit kundër tërmeteve dhe më shumë inkurajohen risqet ndaj terrorizmit. Së fundmi, qeveria Izraelite ngriti një Komitet që të këshillojë qeverinë dhe publikun mbi atë se si të përballojnë në mënyrë sa më të mirë fatkeqësitë natyrore. Një nga çështjet kryesore është rëndësia e sigurimit të përshtatshëm dhe si të arrihet ky objektivi. Në Spanjë, Consorcio de Compensacion de Seguros (CCS) është

angazhuar në dhënien e kompensimeve për humbjet e ndodhura si rezultat i risqeve të jashtëzakonshme. Në këtë kontekst, ajo është aktualisht duke marrë në konsideratë programe që kanë si qëllim për një parandalim më të mirë dhe për reduktimin e humbjeve. Ky projekt do të përfshijë promovimin e fushatave dhe masave parandaluese. Në SHBA, veçanërisht pas serisë së fundit të uraganeve dhe përmbytjeve të njëpasnjëshme, fushatat dhe trajtimi në media kanë qenë në një masë të konsiderueshme intensive për rritjen e ndërgjegjësimit të popullatës mbi domosdoshmërinë për një mbulim me sigurim të përshtatshëm kundrejt risqeve të mëdha dukë përfshirë dhe përmbytjet¹. Shoqata të siguruesve, gjithashtu mund të ndërmarrin programe informuese dhe parandaluese të këtij tipi. Në Japoni, për shembull, Shoqata e Përgjithshme e Siguruesve, në mënyrë sistematike, ndërmerr fushata parandaluese në shkallë të gjerë për të rritur ndërgjegjësimin e konsumatorit mbi risqet e tërmeteve dhe nevojat për mbrojtjen ndaj tyre. Në Gjermani, GDV-ja (shoqatë siguruesish) është e përfshirë në programe për sigurinë e rrugëve dhe gjithashtu ka krijuar një faqe elektronike për fëmijët, duke përdorur lojëra për të shpjeguar masat themelore të sigurisë. Në Francë, një shoqatë e specializuar, *Assureurs, Prevention, Sante*, është duke ndihmuar në krijimin e programeve për parandalimin e risqeve shëndetësore dhe ka promovuar së fundmi një fushatë mbi obezitetin e fëmijëve. Në 2000, pas një serie përmbytjesh dhe fatkeqësive të tjera natyrore, FFSA dhe GEMA (Groupement des Entreprises Mutuelles d'Assurance) u bashkuan për të krijuar një shoqatë, *Mission risques naturels*, për rritjen e ndërgjegjësimit mbi risqet natyrore dhe të sigurojnë ndihmë teknike në politika parandaluese. Në Mbretërinë e Bashkuar, faqja elektronike e ABI siguron një këshillim të përgjithshëm mbi përmbytjet. Gjithashtu, ABI bashkëpunon me Agjencinë për

Mjedisin për të mbështetur angazhimin e industrisë së sigurimeve që të vazhdojnë të ofrojnë produkte të sigurimit ndaj risqeve nga përmbytjet, pjesës më të madhe të shtëpive dhe bizneseve në zonat me risk të lartë përmbytjesh. Në SHBA, Planet e SHBA për Sigurimin Shëndetësor të Amerikës, një shoqatë e siguresve të shëndetit, ka promovuar një strategji gjithëpërfshirëse dhe rekomandime të hollësishme, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi risqet shëndetësore dhe mbi nevojën për forcimin e njohurive të konsumatorëve mbi shëndetin².

Siç është përmendur më parë, disa nga fushatat informative targetojnë segmente specifike të popullatës ose kanë qëllim të promovojnë politika të caktuara. Në Finlandë, programet informuese që targetojnë rininë e hershme dhe imigrantët, janë aplikuar në disa rajone. Veç kësaj, agjencia për mbrojtjen e konsumatorëve Finlandeze ka hartuar një set broshurash mbi menaxhimin financiar dhe mbrojtjen e konsumatorit në momente kyçe, duke përbërë një ndryshim të situatës, siç është të blesh shtëpinë e parë, pensioni apo papunësia, vdekja dhe divorci. Në Gjermani, ministria e familjes, shoqata e konsumatorëve dhe shoqata të industrisë bankare dhe siguresve, kanë krijuar një faqe elektronike³ e projektuar për të ndihmuar studentët të përmirësojnë njohuritë e tyre financiare. Portali përfshin informacion të përgjithshëm mbi produkte të sigurimit. Bizneset e vogla dhe nevojat e tyre specifike për sigurim janë zakonisht targeti i programeve specifike, siç është ai i zhvilluar nga FSA në Mbretërinë e Bashkuar ose Shoqata Kombëtare e Siguresve (NAIC) në SHBA.

2. Roli i medias, instrumentet tradicionale dhe mjetet modernë të komunikimit

Aktorë të ndryshëm konkurojnë me njëri tjetrin në mënyrën se si ata vënë në përdorim median për të qarkulluar në mënyrë efektive informacionin, si të jenë më afër dhe si të

bashkëveprojnë me konsumatorët. Publikime tradicionale mediatike (p.sh. fletëpalosje, broshura, guida dhe publikime të tjera) plotësohen me fushata me anë posterash, fushata me anë reklamash dhe fushata parandaluese në media dhe, në mënyrë rritëse, me anë të internetit, telefonisë celulare, qendra telefonike, pika informimi dhe qendra këshillimi të drejtpërdrejta. Aktivitete si leksione, konferenca dhe fjalime, kanë gjithashtu synimin për të përfshirë konsumatorët gjithnjë e më shumë. Ja vlen që të theksohet që sasia e informacionit në dispozicion është me sa duket më pak e rëndësishme se sa sigurimi i tij në një gjuhë të pastër, që popullata e targetuar të mund t'a kuptojë atë dhe që aksesin për informacion të jetë i thjeshtë dhe sa më shumë i hapur.

Një numër i organizmave shtetërorë, sidomos autoritete mbikëqyrëse dhe aktorë privatë, publikojnë materiale të printuara siç janë broshura, guida, periodikë dhe statistika. Qendra e informimit e industrisë Gjermane të sigurimit prodhon një seri guidash të ashtuquajtura “*Zukunft Klipp und Klar*” që targetojnë nëngrupe specifike të popullsisë (p.sh. familje, persona beqarë, qytetarë të moshuar dhe persona të punësuar), ndërkohë që shoqata e siguresve ka publikuar broshura të qarta dhe të mirëilustruara, të cilat përshkruajnë situata në të cilat sigurimi është shumë i rëndësishëm, avantazhet prej tij dhe pika kontakti në të cilat lexuesit mund të sigurojnë informacion të mëtejshëm përpara se sa të ndërmarrin një politikë sigurimi. Këshilli Kanadez i Rregullatorëve në Sigurime (CCIR) është përfshirë në një projekt, i cili ka si qëllim të promovojë praktikën më të mira të shitjes së produkteve dhe shërbimeve në sektorin financiar. Një element kyç i projektit është publikimi i guidës së konsumatorit për transaksionet financiare. Në Itali, në 2004, një guidë praktike për sigurimet u publikua si një suplement i një

gazete me një qarkullim të gjerë kombëtar, duke siguruar informacion jo teknik në një gjuhë të thjeshtë rreth produkteve më të zakonshme të sigurimit (sigurimi i mjeteve motorike, sigurimi i jetës dhe pensioni). Në Hollandë, një fletëpalosje u vu në dispozicion të konsumatorëve që në vitin 2002, duke dhënë informacion objektiv, preciz dhe të krahasueshëm mbi karakteristikat kryesore të produkteve komplekse të sigurimit. Në Poloni, avokati i popullit (ombudsman) për sigurimet, publikon një revistë mbi sigurimet, e cila dërgohet tek shoqatat e konsumatorëve, kompanitë e sigurimit, universitetet dhe individët privatë. Në Japoni, këshilli qendror për informimin mbi shërbimet financiare publikoi një guidë mbi edukimin financiar në Mars 2005.

Mediat e përgjithshme (p.sh TV, radio, shtypi dhe postera) janë shndërruar në mjete të natyrshme për fushata parandaluese duke targetuar risqe të caktuara dhe fushata promovimi për tipe të caktuara thelbësore të mbulimit në sigurim (motorrike, pensione dhe të kujdesit afatgjatë, etj.) ose për të rritur ndërgjegjësimin në përgjithësi mbi edukimin financiar. Strategjia e Dhomës Polake të Sigurimit është në mënyrë të veçantë udhëzuese, duke synuar informimin dhe sensibilizimin e gazetarëve në botën e sigurimeve, me qëllim përmirësimin e nivelit të përgjithshëm të informimit rreth sigurimeve brenda medias në tërësi. Një numër iniciativash kanë marrë rrugë që në vitin 2003, duke përfshirë takime specifike të gazetarëve me kompanitë e mëdha të sigurimit (p.sh. ING Nationale Nederlanden, TUnZ SA, PZU SA). Në Australi, krijimi i Fondacionit të Edukimit Financiar, promovimi i faqes së tij elektronike si dhe organizimi i Forumit të parë mbi Edukimin Financiar, i mbajtur në Canberra në Shtator 2005⁴ dhanë kontribut në rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbulimit nga ana e

medias të çështjeve mbi edukimin financiar.

Vijon në numrin tjetër ...

Shënime:

1. Për informacion të mëtejshëm mbi mbulimin nga ana e medias, të riskut nga përmbytjet në SHBA, shikoni faqen elektronike të Institutit për Informacionin mbi Sigurimet: www.iii.org dhe veçanërisht Robert P. Hartwig, (2006).
2. Për detaje të mëtejshme shikoni faqen elektronike të AHIP: www.ahip.org
3. www.unterrichtshilfe-finanzkompetenz.de.
4. Forumi është organizuar në Ndërtesën e Parlamentit, 16 Shtator 2005 dhe mbledhi bordin këshillues të Fondacionit, përfaqësues të Qeverisë Australiane, biznese, lider në sektorët e edukimit dhe komunikacionit për të dhënë ekspertizën e tyre. Forumi për Edukimin Financiar eksploroj elementët kyç të strategjisë së Qeverisë për të siguruar një përfaqje të koordinuar kombëtare, realizuar angazhimin e tij, me qëllim për të ndihmuar të gjithë australianët të rrisin njohuritë e tyre financiare dhe për një kuptim më të mirë të opsioneve dhe zgjedhjeve që ata mund të bëjnë në përdorimin dhe menaxhimin e parave të tyre.

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, V. Theodhori
O Zaçaj, P. Berberi, A. Lleshi
K. Haxhi, R. Eltari, S. Zalta, E. Kokona

